



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 555/1 Prot.

Tiranë, më 04/06 /2019

V E N D I M

Nr. 11 datë 04.06 . 2019

“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 2, DATË 15.01.2019 TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT “PËR MIRATIMIN E EFEKTIT FINANCIAR TË ZBATIMIT TË VKM-VE TË PAKETËS STUDENTORE PËR UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, SI DHE MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË TË CILËT PËRJASHTOHEM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT DHE LISTËN E STUDENTËVE TË CIKLIT TË DYTË TË CILËT PËRFITOJNË NGA REDUKTIMI I TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË MASËN 50 %”.

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së nr.269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” të ndryshuar; VKM-së nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programe të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë” si dhe në kërkesat e njëjësive kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 2, datë 15.01.2019 të Bordit të Administrimit bëhet një shtesë në listën e studentëve të ciklit të parë të cilët përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, si dhe në listën e studentëve të ciklit të dytë të cilët përfitojnë nga reduktimi i tarifës vjetore të shkollimit në masën 50 %, sipas listave bashkëlidhur.
2. Ky vendim t’i njoftohet MASR-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2019, sipas pasqyrës nr.1 bashkëlidhur.
3. Ngarkohen Administratori i Institucionit si dhe njësitë kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Kryetar,
Arben DHIMA

